



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike
Mbledhja nr. 11
Prishtinë, më 05 maj 2010, ora 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJE TË FINANCAVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Haki Shatri, Safete Hadergjonaj, Kosara Nikoliq, Riza Smaka, Synavere Rysha dhe Enis Kervan.

Mungoi: Anita Morina –Saraçi, Gani Koci dhe Naser Osmani.

Të pranishëm: nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit, Fatime Qorri - zyrtare ligjore, KIPRED (staf mbështetës) Artan Venhari dhe Albert Krasniqi, Shpresa Miftari – praktikante, ZAP- Ilire Daija-Buza, OSBE - Lejla Selimi, KDI – Jusuf Zejna dhe nga Zyra e Presidentit Nexhat Shatri.

Mbledhjen e kryesoi Haki Shatri, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite

- 1. Miratimi i rendit të ditës,**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dt. 13.04. 2010,**
- 3. Shqyrtimi i raportit të Komisionit vlerësues për përzgjedhjen e auditorit të jashtëm për auditimin e pasqyrave financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2008 dhe 2009,**
- 4. Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Synavere Rysha – propozoi që rendi i ditës të jetë jo “Shqyrtimi i raportit të Komisionit vlerësues për përzgjedhjen e auditorit të jashtëm për auditimin e pasqyrave financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2008 dhe 2009”, por “Shqyrtimi i raportit të komisionit vlerësues për përzgjedhjen e kompanisë audituese për auditimin e pasqyrave financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2008 dhe 2009”.

Rendi i ditës u miratua me propozimin e deputetes Synavere Rysha.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 02 shkurt 2010

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 13.04. 2010.

3. Shqyrtimi i raportit të Komisionit vlerësues për përzgjedhjen e kompanisë audituese për auditimin e pasqyrave financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2008 dhe 2009

KRYESUESI – Njoftoi anëtarët e komisionit se Komisioni vlerësues për përzgjedhjen e një kompanie e cila do të bëjë auditimin e Auditorit të Përgjithshëm, ka përgaditur një raport të cilin e ka ofruar për shqyrtim dhe procedim të mëtejshëm në KMFP. Hap diskutimin.

Riza SMAKA - kryesues i Komisionit vlerësues – Tha se Komisioni vlerësues i ka shqyrtuar dhe i ka analizuar shkruesat e marra nga Administrata e Kuvendit dhe ka konstatuar se konform me nenin 30 të Ligjit të Prokurimit nr 2007/20, gjate procedurave të prokurimit për përzgjedhjen e auditorit të jashtëm për auditimin e ZAP-it, janë parashtruar vetëm dy oferta të përgjegjshme, por jo së paku tri të përgjegjshme. Për këtë shkak organi i njoftimit për kontratë, do të duhej të anulonte aktivitetin e vet të prokurimit dhe të shpall ftesën e dytë të tenderit. Komisioni vlerëson se shuma nuk është e madhe dhe ka njëmend tenderues, përveç disa kërkesave që janë pak a shumë problematike si “*shuma e sigurimit*”. Në këtë rast mund të veprohet vetëm sipas dispozitës ligjore.

KRYESUESI– Tha se ka kërkuar nga shefi i zyrës së prokurimit të Kuvendit të jap sqarim në kriterin “*polisa e sigurimit 2 milionë euro*”. Në njoftim për kontratë, nuk është kërkuar shuma se sa do të jetë shkalla e sigurisë etj. Këtu shkruan sigurimi i ekzekutimit (te pika 3.1), por nuk kemi kriter të caktuar. Kërkoj shpjegim lidhur me atë nëse niveli i sigurisë prej 2 milion është i domosdoshëm edhe për raste të tenderimit të punëve që kapin shumat deri në 10 000 euro. A ka qenë kriter i domosdoshëm? Krejt kjo me kusht që të kemi minimumi 3 ofertues të përgjegjshëm dhe të mundet Komisioni t’i rekomandojë Kryesisë së Kuvendit një regjistër. A mundet dikush pas shpalljes së njoftimit për kontratë të vendos kritere - pengesa të tilla si çështja e polisës së sigurimit?

Synavere RYSHA – Anëtare e Komisionit vlerësues, ka pasur vërejtje në njoftimin për kontratë, në të cilin njoftim nuk është paraparë polisa e sigurimit kaq e lartë, duke marrë parasysh tregun dhe rrethanat në Kosovë. Nga të gjithë ofertuesit, të gjithë janë të përgjegjshëm, domethënë kanë plotësuar kriteret, përveç “*polisës së sigurimit 2 milion euro*”. Përderisa, ky kriter nuk është paraparë në njoftimin për kontratë, me çfarë të drejte këta ofertues do të mund të eliminohen nga gara? Ligji kërkon 3-5% të vlerës së tenderit - sigurim për kontratë, që në këtë rast është dashur të jetë 250 – 500 euro, pra është fjala për sigurim të ofertës, mirëpo këtu është kërkuar një sigurim tjetër. Kam kontaktuar me njërin nga anëtarët e KBF se si ka ndodh kjo çështje dhe jam informuar se këto janë çështje me përgjegjësi – kërkohet polisa e sigurimit prej 2 milion eurove. Kompanitë kanë të drejtë të bëjnë ankesë, për shkak se kemi bërë shkelje të ligjit, ne si grup apo ne si Kuvend.

Ajo shtoi se si anëtare e komisionit vlerësues nuk ka pasur në dorë dosjen e tenderit. Shefi i prokurimit i ka njoftuar dhe në bazë të asaj komisioni ka vendosur. Baza fillon me njoftimin për kontratë. Nëse kriteri 2 milion euro është i obligueshëm, atëherë është dashur të paraqitet në njoftimin për kontratë. Kjo pengesë është paraqitur pas fillimit të procedurave. Pas shpalljes së njoftimit për kontratë, nuk guxon të ndryshoi asgjë. Prandaj, me këtë kriter nuk mund të eliminohen nga gara ofertuesit.

Naim GJOSHI – shef i prokurimit –Tha se ka proceduar në bazë të kërkesës së dhënë nga njësia e kërkesës-Divizioni për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për lëgjisllacion. Nga dokumentacioni që i është dorëzuar, ka bërë përgatitjen e dosjes së tenderit. Nga vendimi i Kryesisë, nga raportet

dhe rekomandimet që ka marrë, materiali që është dashur t'i bashkangjitet si specifikacione të dosjes së tenderit. Në këto specifika është e pasqyruar edhe siguria për shkak të specifikimeve apo për shkak të materialit që duhet të kryhet. Është kërkuar një siguri dhe garancë që të jetë një vlerë e caktuar e sigurimit të dosjes së tenderit dhe e ekzekutimit, çka kompanitë që kanë ofertuar nuk i kanë prezentuar, realisht kompanitë që kanë ofertuar nuk e kanë prezentuar garancën prej 2 milionë eurove. Çdo gjë ka qenë e specifikuar në dosjen e tenderit. Si shëf i prokurimit është i obliguar ta respektojë pikë për pikë në bazë të njësisë së kërkesës. Për të gjitha kam kërkuar dokumentacione dhe unë jam i obliguar që të respektojë vetëm kërkesat që vijnë nga organet kompetente.

Safete HADERGJONAJ –Që nga fillimi ka qenë kundër asaj që anëtarët e KMFP të marrin pjesë në vlerësim të një tenderi, megjithatë Komisioni ka ardh me përfundim se duhet të respektohet vendimi i Kryesisë. Specifikimet teknike ipen me dosjen e tenderit. Ndoshta të gjitha këto specifika teknike, nuk paraqiten në lajmërimet. Komisioni mund t'i drejtohet edhe Agjensionit të Pavarur të Prokurimit për revokim të nenit 30.3 të Ligjit të Prokurimit Publik dhe të shkohet me dy oferta të përgjegjshme, për shkak të rrethanës së krijuar. Nëse APP-ja vlerëson se kjo vërtetë është një shkelje e madhe, kërkon anulimin e aktiviteteve të prokurimit.

Kosara NIKOLIQ – Ka qenë kundër asaj që deputetët të merren me këtë çështje, megjithatë ajo tha se vendimi i Kryesisë së Kuvendit duhet respektuar. Sipas saj kjo çështje nuk duhet të debatohet. Por, të ndryshohet Ligji i Prokurimit me procedurë të shkurtër ose të merret një vendim dhe të shpallet sërish tenderi, por pa 2 milionë euro siguri - të jetë një vlerë më e vogël.

KRYESUESI –Tha se nuk kemi arsye t'i drejtohem APP-së, sepse në këtë rast ne kemi gjashtë ofertues. Insistoi që të shihet pse është vënë kjo pengesë që si duket është e qëllimshme. Kush ka të drejtë? Së bashku me shëfin e zyrës së prokurimit e kanë harmonizuar bashkarisht dosjen e tenderit dhe i ka thënë se *“sa më përket mua kjo është rruga e rregullt, për ta publikuar tenderin”*. Por, në ndërkohë dikush vendos kritere, të cilat i lënë jashtë procedure disa ofertues të përgjegjshëm. Në njoftimin për kontratë nuk shkruan shuma 2 milionë euro, ndërsa në tabela 3.1, ku shkruan kapaciteti i ekzekutimit të shërbimeve dhe a është e nevojshme siguria e tenderit, shkruan po, por nuk shkruan shuma.

Rregullorja e punës së Kuvendit, është miratuar dhe në pjesën e kompetencave të këtij Komisioni është përshkruar përzgjedhja e auditorit të jashtëm që do ta auditoj Auditorin e Përgjithshëm është kompetencë dhe obligim ekskluziv i këtij KMFP. KMFP duhet ta kryej këtë detyrë, mund të marr vendim për ritenderim, por kjo nuk është e mjaftueshme. Duhet kërkuar përgjegjësi.

Safete HADERGJONAJ – Tha, kryesuesi ka parë dosjen e tenderit më herët, prandaj pyeti: a ka qenë në atë dosje kushti për siguri, sepse nëse kryesuesi ka lexuar dosjen dhe ky kriter nuk ka qenë i përfshirë në atë dosje, atëherë vërtetë është fjala për diçka që është bërë gjatë procedurës. Këtu lind pyetja: kompanitë të cilat merren me auditim në momentin kur ato fitojnë licencën vendore dhe ndërkombëtare, a janë të obliguara të kenë polisën e sigurimit? A janë të obliguara këto që për të bërë një auditim të natyrës ndërkombëtare, duhet ta kenë gjithsesi polisën e sigurimit. Kjo është një polisë e obligueshme për shumicën e bizneseve. Nëse këta duhet ta kenë polisën e sigurimit për të bërë një auditim vendor dhe ndërkombëtarë, atëherë ky është një kusht dhe ne nuk mund të themi është shtuar gjatë rrugës apo jo. Në të kundërtën kjo është e panevojshme dhe ne mund të ecim tutje. Kryesuesi tha se kanë dal pengesa të qëllimshme rrugës, prandaj pyeti: ku është qëllimi që ZAP të mos ketë auditim? Dosja për ofertuesit është ligj, siguri i tenderit duhet dalluar nga polisa e sigurimit.

KRYESUESI–Tha se kanë dikustuar dhe janë pajtuar në parim me zyrën e prokurimit, para se të publikohej njoftimi për kontratë. Kriteri 2 milion nuk ka qenë. Për të është e pabesueshme kur ka ofertues-kompani që realizojnë me nga 40 miliard qarkullim në vit dhe kanë përfaqësitë e tyre

në Prishtinë, mos t'i përmbushin kriteret e parpara për këtë çështje. Pyeti: në cilin nen të Ligjit për Prokurimin bazohet kriteri “*polisë e sigurimit prej 2 milion euro*”

Naim GJOSHI – Tha se ka vepruar sipas materialit që është proceduar në Divizionin e Prokurimit. Polisa e sigurimit nuk guxon të përfshihet në njoftimin për kontratë, ndërsa në specifikimet teknike është kërkuar polisa e sigurimit. Sigurimi i tenderit kërkohet në hapin e parë që është 3 -5%, ndërsa në hapin e dytë - te kriteret teknike, kërkohet polisa e sigurimit 2 milion. Ky është kriter i vlerësimit dhe ju si Komision do të vendosni a do të vazhdoni me procedurën e vlerësimit apo do t'i anuloni dhe do t'i qoni në ritenderim. Komisioni vendos a do të respektohen kriteret në mënyrë strikte.

Enis KERVAN- Ne si komison kemi formuar Komisionin vlerësues. Kryesuesi i këtij komisioni e sçaroi se si ka punuar grupi. Nëse nuk ka pengesa – polisa e sigurimit nuk është kriter - atëherë përse diskutohet? Pajtohet me propozimin që pas afatit ligjor të palëve për ankesë, të rishpallet njoftimi për kontratë.

Riza SMAKA- Ishte i mendimit se dispozitat ligjore duhet të respektohen në mënyrë rigoroze. Ai tha se Komisioni vlerësues ka punuar në bazë të rregullave dhe standardeve. Ka marrë informacion se vetëm dy nga ofertuesit i plotësojnë kriteret e kërkuara me ligj. Ligji thotë që duhet të jenë së paku tre ofertues që i plotësojnë kushtet dhe mbi këtë bazë Komisioni ka rekomanduar, ka vendosur në mënyrë unanime dhe personalisht do të angazhohet që të përfilllet ky mendim i këtij Komisioni. Në këtë fazë Komisioni nuk është kompetent për të përcaktuar kriteret. Kriteret e parpara për këtë çështje mund të mos jenë të mira, por tenderi është shpallur me këto standarde dhe si të tilla janë të obligueshme. Komisioni nuk mund të bëjë revidime të kriteve.

KRYESUESI – Pyeti: a ka pasur mundësi Komisioni vlerësues gjatë punës të kërkojë nga ofertuesit polisën e sigurimit? Komisioni vlerësues ka përgaditur një raport dhe në bazë të kësaj ne mundemi vetëm të presim afatin ligjor për ankesa nga palët e interesuara, pastaj të shpallet njoftimi i dytë për kontratë. Zyra e Prokurimit nuk i ka shërbyer drejtë Komisionit vlerësues, nuk është dashur të bëjë hapjen e ofertave pa Komisionin, nuk është dashur të ndikoi në punën e Komisionit me veprimet e tyre.

Safete HADERGJONAJ- Tha se kur të hapet oferta nuk mund të kërkohen dokumente shtesë. Dosja e tenderit të cilën e merr ofertuesi është ligj për të. Garancioni bankar për firmën është obligativ. Nuk ka arsye për politizim të çështjes. Janë dy mundësi: të kërkojmë nga APP të bëjë revokimin e nenit 30 të LPP, për të proceduar pastaj me dy oferta të përgjegjshme, ose të kërkojmë nga Kryesia e Kuvendit anulimin e aktiviteteve të prokurimit dhe rishpalljen e ftesës së re për tender. Vendimi i Kryesisë na ngarkon vetëm për vlerësimin e ofertave e jo për hapjen e tyre. Ju z.kryesues jeni i interesuar që ky Komision mos të funksionoi. Duhet vepruar në bazë të rregullativave ligjore. Komisioni vlerësues ka përgaditur një raport dhe në këtë raport nuk figuron se pengesa është polisa e sigurimit prej 2 milion eurove.

Kosara NIKOLIQ - Tha, puna e Komisionit vlerësues ka qenë nëse janë plotësuar kushtet sipas ligjit. Sipas Komisionit këto kushte nuk janë plotësuar, sepse kemi pasur vetëm dy ofertues të përgjegjshëm, prandaj edhe kemi bërë rekomandimin për anulimin e aktiviteteve të prokurimit dhe rishpalljen e njoftimit për kontratë.

Pas diskutimeve të deputetëve kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri nxorri këtë

REKOMANDIM

1. Të kërkoj nga organi i shpalljes së njoftimit për kontratë, që të anulohet aktivitetet e prokurimit për përzgjedhjen e Auditorit të Jashtëm, për auditimin e pasqyrave financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, për vitin 2008 dhe 2009, kjo konform nenit 30.3 të Ligjit nr. 2007/20 për Prokurimin Publik në Kosovë.
2. Pasi të kaloi afati ligjor për ankesë për palët e interesuara, të kërkoj nga organi i shpalljes së njoftimit për kontratë, që të rishpallë ftesën e dytë për tender.

Mbledhja përfundoi në orën 14:10

Përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Haki Shatri